



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Data: 18.07.2024

Nr: 91

V E N D I M

P Ë R

PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT PËR OPERATORËT TEKNIKË PËR PËRDORIMIN E PAJISJES SË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE (PEI), PËR ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, QARKU VJORË, TË DATËS 4 GUSHT 2024

Në mbështetje të nenit 14, pika 2 dhe nenit 19, pika 1, shkronja “n”, dhe pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

V E N D O S I M

1. Operatorët teknikë për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI), për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Himarë të datës 04.08.2024, përfitojnë shpërblim në masën 10,000 (dhjetë mijë) lekë.
2. Efekti financiar sipas pikës 1 i këtij vendimi përballohet nga buxheti i miratuar për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI